1. Miratimin e “Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në ushtrim të detyrave funksionale të ngarkuara me ligj”.
2. Bashkëlidhur këtij vendimi, Strategjia e Menaxhimit të Riskut për vitin 2019.
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

VENDIME PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJEVE TË BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONE

Vendim nr. 33, datë 05.02.2019 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I

1. Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Qendrës së Bashkëpunimit Ndërfetar.
2. Dërgimin e Marrëveshjes për vazhdimin e procedurave Qendrës së Bashkëpunimit Ndërfetar.
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtarë: Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

Vendim nr. 53, datë 14.02.2019 (i shkurtuar)

Bazuar në ligjin nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit,

V E N D O S I

1. Miratimin e Marrëveshjes ndërmjet Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Wikimedians of Albanian Language User Group (WoALUG).
2. Dërgimin e Marrëveshjes për vazhdimin e procedurave Wikimedians of Albanian Language User Group (WoALUG).
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Gentiana Sula

Anëtarë: Altin Hoxha, Marenglen Kasmi, Simon Mirakaj

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 1, datë 22.01.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 1, datë 22.01.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish - Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. **Dosje drejtimi për internim dëbimet** nr. 254, me 3 fashikuj. Dosja ka 587 (pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1975-1991.
2. **Dosje me propozime për internim dëbime** (persona familjarë të pushkatuar), dy dosje me 140 (njëqind e dyzetë) fletë dhe kopja me 110 (njëqind e dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1982.
3. **Regjistër asgjësimi i internim – dëbimeve** në rrethe, me 100 (njëqind) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Daton në vitin 1973.
4. **Lista e të arratisurve** si Republikë, sipas rendit alfabetik, me 342 (treqind e dyzet e dy) fletë. Dokumentet datojnë që në vitin 1944.
5. **Dosje e Objektivit të Rëndësisë Veçantë për R. 313 dhe 325.** Dy fashikuj me nr. regjistri 186. Fashikulli I, me 34 (tridhjetë e katër) fletë. Fashikulli II, me dy volume me 129 (njëqind e njëzet e nëntë) fletë dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1972-1988.
6. **Dosje skuadra e futbollit të H. “A”** me 30 (tridhjetë) fletë + zarf me 41 (dyzet e një) foto. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1970.
7. **Dosje skuadra e futbollit të I. së V.** me 20 (njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1965.

8. **Historiku i S.Sh. të D.P.B.T.**, vol. 1, me 316 (treqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”. Dokumenti daton në vitet 1943-1970.
9. **Historiku i S.Sh. të D.P.B.T.**, vol. 2, me 108 (njëqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”. Dokumenti daton në vitet 1971-1975.
10. **Dosje të Drejtimit të Z. P.**, nr.100 dhe fashikull i agjunkturës me gjithsej 264 (dyqind e gjashtëdhjetë e katër) fletë. Dosja nr. 179 dhe fashikull i agjunkturës me gjithsej 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjeve është “sekret”. Dokumentet e dosjeve datojnë në vitet 1973-1991.
11. **Dosje drejtimi nr. 167** me 2 (dy) fashikuj mbi veprimtarinë armiqësore në reparte të ndryshme të riedukimit (burgjet 301, 303, 305, 309, 315, etj), me 437(katërqind e tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit është “sekret”. Dokumentet e dosjeve datojnë në vitet 1973-1984.
12. **Dosje objekti nr. 1061**, në ngarkim të “R. të R.”. Dosja ka gjithsej 156 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1974-1991.
13. **Dosje drejtimi nr. 3**, në ngarkim të “R. të R.”, me fashikull mbi agjunkturën e reparteve të riedukimit në burgje. Dosja ka gjithsej 220 (dyqind e njëzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1984-1991.
14. **Dosje e O.R.V. nr. 68**, në ngarkim të R. të R. nr. 301/1 B. Dosja ka 3 (tre) fashikuj me gjithsej 90 (nëntëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1977-1985.
15. **Dosje e O.R.V. nr. 146**, në ngarkim të R. të R. nr. 311, Q. B. - P. Dosja ka 2 (dy) fashikuj me gjithsej 93 (nëntëdhjetë e tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1973-1985.
16. **Regjistër themeltar për të internuar dhe dëbuar në rrethin e P., gr. 2/B.** Regjistri është model 1 me 30(tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
17. **Dosje me dokumente për masat kur arratisen të burgosurit**, në ngarkim të R.303 S. Dosja përmban 14 (katërmëdhjetë) skica dhe 1(një) hartë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “s.r.v”.

18. **Dosje formulare nr.1317**, kategoria 2B, në ngarkim të A.B.G., me 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1955-1962.
19. **Fashikull nr. 456**, në ngarkim të M. K. C., me 163 (njëqind e gjashtëdhjetë e tri) fletë dhe 2 foto në zarf. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1948-1992.
20. **Dosje formulare nr. 4842**, kategoria 2/B, në ngarkim të L. G. B., me 32 (tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1953-1986.
21. **Dosje hetimore nr. 782**, në ngarkim të P. M. D., me 30 (tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1948-1978.
22. **Dosje formulare nr. 1446**, kategoria 2A, në ngarkim të H.G.G., me 150 (njëqind e pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1962-1979.
23. **Fashikull me nr. 5669** në ngarkim të A. K., me 2 (dy) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1961-1970.
24. **Dosje formulare nr. 1101**, kategoria 2A, në ngarkim të D. I. P., me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1971-1979.
25. **Dosje formulare nr. 6671**, kategoria 2A, në ngarkim të D. A. A., me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Fashikull personal për të dënuar me nr. indeksi 75, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1978-1991.
26. **Dosje përpunimi, nr. regjistri 12 765**, kategoria 2A, në ngarkim të M. A. K., me 104 (njëqind e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1980-1990.
27. **Dosje përpunimi nr. 2495**, kategoria 2B, në ngarkim të Gj. P. K., me 298 (dyqind e nëntëdhjetë e tetë) fletë dhe zarf me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Fashikull personal për të dënuar nr. 311, me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1959-1991.

28. **Dosje përpunimi nr. 988**, kategoria 2B, në ngarkim të Z. R. A., me 41 (dyzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1958-1988.
29. **Dosje formulare nr. 3880-A**, në ngarkim të E. Ç. Dosja ka 408 (katërqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1959-1983.
30. **Dosje formulare nr. 2432**, në ngarkim të E. Ç. Dosja ka 687 (gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1953-1977.
31. **Dosje formulare nr. 758**, kategoria 2A, në ngarkim të Xh. B. A., dy volume me 416 (katërqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë dhe zarfi. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1945-1978.
32. **Dosje formulare nr. 1627 dhe 1627/1**, kategoria 2A, në ngarkim të N. I. Z., me 488 (katërqind e tetëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1964-1990.
33. **Dosje nr. 4381** me fashikull me materiale të përbashkëta të përpunimit agjenturial “K. Z.”, me 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1973-1974.
34. **Dosje formulare nr. 1594**, kategoria 2A, në ngarkim të B. S. B., me 150 (njëqind e pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1975-1985.
35. **Dosje formulare nr. 605**, kategoria 2A-2B, në ngarkim të B. I. D., me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1961-1978.
36. **Dosje formulare nr. 951**, kategoria 2B, në ngarkim të I. E. Z., me 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1959-1987.
37. **Dosje formulare nr. 1840**, kategoria 2A, në ngarkim të V. A. S., me 89 (tetëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1934-1950.

38. **Dosje personale dhe pune nr. 70**, në ngarkim të B.A.. Dosja personale ka 37 (tridhjetë e shtatë) fletë dhe dosja e punës, 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1976-1989.
39. **Dosje përpunimi nr. 814**, kategoria 2B, në ngarkim të N. Xh. S., me 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë dhe fashikull personal për të dënuar, me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1963-1989.
40. **Dosje përpunimi nr. 1065**, kategoria 2B, në ngarkim të T. F. G., me 33 (tridhjetë e tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1973-1990.
41. **Fashikull** në ngarkim të M. N. Sh., me 73 (shtatëdhjetë e tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1989-1991.
42. Fletë regjistri, e shkëputur nga **Regjistër agjenture** model K.I. nr. 1/1. Regjistri i përket ish-Drejtorisë së Punëve të Brendshme Tiranë, me 1 (një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
43. **Dosje formulare nr. 1985**, kategoria 2A, në ngarkim të S. Q. P., me 234 (dyqind e tridhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1952-1992.
44. **Dosje përpunimi nr. 1452**, kategoria 2B, në ngarkim të J. V., me 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1964-1991.
45. **Dosje formulare nr. 3325**, kategoria 2A, në ngarkim të K. H. L., me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1982-1987.
46. **Dosje përpunimi nr. 9233**, kategoria 2A, në ngarkim të Gj. N. M., me 210 (dyqind e dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1950-1982.
47. **Dosje përpunimi nr. 5431**, kategoria 2A, në ngarkim të Gj. T. H., me 86 (tetëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitet 1985-1988.

48. **Dosje hetimore-gjyqësore nr.157** në ngarkim të Gj. T. H., 2 volume me 54 (pesëdhjetë e katër) dhe 132 (njëqind e tridhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. Dokumentet e dosjes datojnë në vitin 1987.
49. Fotokopje e **kartelës model 2**, me nr. regjistri 8023 për B. R. Sh.. Niveli i klasifikimit “sekret”. 1 (një) fletë.
50. Fotokopje e **kartelës model 2**, me nr. regjistri 7843 për A. Dh. B. Niveli i klasifikimit “sekret”. 1 (një) fletë.
51. Fotokopje e **kartelës model 2**, me nr. regjistri 2906 për M. U. H. Niveli i klasifikimit “sekret”. 1 (një) fletë.
52. Fotokopje e **kartelës model 2**, me nr. regjistri 2802 për E. G. S. Niveli i klasifikimit “sekret”. 1 (një) fletë.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 2, datë 18.02.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar”, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhër nr.13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 2, datë 18.02.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. **Dosje personale dhe pune nr. 110**, K. Gj. K., me 43 (dyzet e tre) fletë dhe dosja e punës me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
2. **Kartelë model 2, nr. 110** në ngarkim të K.Gj.K.. Niveli i klasifikimit “sekret”.

3. **Fletë regjistri** (pjesërisht) **nr. 110**, në ngarkim të K.Gj.K, niveli i klasifikimit “sekret”. 2 (dy) fletë.
4. **Dosje formulare nr. 3484**, kategoria 2/B, në ngarkim të N. T. K., me 79 (shtatëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
5. **Kartelë model 2, nr. 3485** në ngarkim të N. T. K. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. 2 (dy) fletë.
6. **Dosje përpunimi, nr. 2316**, kategoria 2B, në ngarkim të A. S. N., me 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
7. **Dosje përpunimi nr. 953**, kategoria 2B, në ngarkim të B. I. H., me 83 (tetëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
8. **Dosje fashikullore nr. 2572**, në ngarkim të I. H. F., dy volume me 100 (njëqind) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
9. **Dosje përpunimi nr. 3267**, kategoria 2B, në ngarkim të M. B. F., me 173 (njëqind e shtatëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
10. **Fletë regjistri**, (pjesërisht) dega IV, me nr. **894**, në ngarkim të M. B. F. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. 2 (dy) fletë.
11. **Fletë regjistri** i agjencurës Tiranë, (pjesërisht) nr. **2331**, ngarkim të M. B. F. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. 2 (dy) fletë.
12. **Dosje formulare nr. 2625**, kategoria 2A, në ngarkim të N. K. H., me 158 (njëqind e pesëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
13. **Dosje përpunimi nr. 12.091 dhe fashikull personal për të dënuar** në ngarkim të F. I. D., kategoria 2A, me 95 (nëntëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
14. **Dosje formulare nr. 44**, kategoria 2B, në ngarkim të T. T. D., me 52 (pesëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
15. **Dosje formulare nr. 651**, kategoria 2A, në ngarkim të I. XH. D., me 86 (tetëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
16. **Dosje përpunimi nr. 2392**, kategoria 2B, në ngarkim të V. K. C., me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

17. **Dosje përpunimi nr. 1067**, kategoria 2B, në ngarkim të S. R. A. (H) me 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
18. **Fletë regjistri i agjunkturës Tropojë**, (pjesërisht) në ngarkim të M. H. K., me numër. **918**, 2 fletë. Niveli i klasifikimit të regjistrit është “A.R.P.”. 2 (dy fletë)
19. **Fletë regjistri i agjunkturës Krujë**, (pjesërisht) në ngarkim të N. T. A., me numër. **1236**, Niveli i klasifikimit të regjistrit është “A.R.P.”. 2 (dy) fletë.
20. **Dosje formulare nr. 230**, kategoria 2A, në ngarkim të D. H. Z. në grupin “S”, me 148 (njëqind e dyzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
21. **Dosje përpunimi nr. 186**, kategoria 2B, në ngarkim të D. H. Z., me 49 (dyzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
22. **Dosje përpunimi nr. 27**, kategoria 2B, në ngarkim të A.TH. A. me 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
23. **Dosje formulare nr. 55**, kategoria 2A, në ngarkim të D. TH. M., me 215 (dyqind e pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
24. **Dosje formulare nr. 109**, kategoria 2B, në ngarkim të U. H. H., me 44 (dyzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
25. **Dosje përpunimi nr. 12164**, kategoria 2A, në ngarkim të N. K. T., me 102 (njëqind e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
26. **Fletë regjistri i agjunkturës Tiranë nr. 3450**, (pjesërisht) në ngarkim të N. K. T. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”. 2 (dy) fletë.
27. **Dosje agjenciale e problemit të centralizuar “gj”**, me dy volume **nr. 327 dhe 327/1** në ngarkim të N. K. T. me 408 (katërqind e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
28. **Dosje formulare nr. 176**, kategoria 2A, në ngarkim të TH. Ll. M. me 133 (njëqind e tridhjetë e tri) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
29. **Dosje përpunimi nr. 4985**, kategoria 2B, në ngarkim të L. S. Ç., dy volume me 100 (njëqind) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

30. **Dosje formulare nr. 1266**, kategoria 2A, në ngarkim të A. T. D., me 218 (dyqind e tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
31. **Dosje përpunimi nr. 2927**, kategoria 2B, në ngarkim të G. S. P., me 140 (njëqind e dyzet) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
32. **Dosje përpunimi nr. 2239**, kategoria 2B, në ngarkim të R. M. D., me 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
33. **Dosje përpunimi nr. 234**, kategoria 2A, në ngarkim të I. H. N., me 163 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
34. **Fletë regjistri** i agjencurës Tiranë **nr. 12.210**, (pjesërisht) në ngarkim të V. F. V. me 395 (treqind e nëntëdhjetë e pesë) fletë. Regjistri i përket ish-Degës së Punëve të Brendshme Tiranë.
35. **Fletë regjistri** i agjencurës Tiranë **nr. 12.621**, (pjesërisht) në ngarkim të G. Q. K. me 395 (treqind e nëntëdhjetë e pesë) fletë. Regjistri i përket ish-Degës së Punëve të Brendshme Tiranë.
36. **Dosje përpunimi nr. 6199**, kategoria 2A, në ngarkim të Q. B. V. Dosja e përpunimit ka 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) fletë.
37. **Dosje formulare nr. 519**, kategoria 2/A, në ngarkim të Xh. S., me 107 (njëqind e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
38. **Dosje formulare nr. 516**, kategoria 2/A, në ngarkim të A. V. K., me 162 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
39. **Dosje formulare nr. 1518**, kategoria 2A, në ngarkim të V. B. B., me 211 (dyqind e njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
40. **Dosje agjencuriale “Rrjeta e Zezë”**, 2 volume, nr. **2368/A** dhe **2368/A1**, në ngarkim të V. B. B., me 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
41. **Dosje formulare nr. 334**, kategoria 2/A, në ngarkim të B. K, me 30 (tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
42. **Dosje formulare nr. 3328**, kategoria 2/B, në ngarkim të Th. P, me 175 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

43. **Dosje kërkimi nr. 2642**, në ngarkim të B. V. (S.) me 75 (shtatëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
44. **Dosje formulare nr. 3379**, kategoria 2B, në ngarkim të Q. A. Ç. me 28 (njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
45. **Dosje kërkimi nr. 718/28**, në ngarkim të M. Gj. (K.), me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
46. **Dosje hetimore nr. 207 dhe dosje gjyqësore nr. 16**, në ngarkim të P. M., me 309 (treqind e nëntë) fletë në total.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 3, datë 25.02.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu III, neni 4, pika a), c), Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 13, datë 03.05.2018, të Kryetares së Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e plotë të dosjeve të klasifikuara “sekret shtetëror”, me vendimin nr. 3, datë 25.02.2019, si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH

1. **Dosje e të arratisurit, nr. 3107-D-65**, në ngarkim të L. B. Dosja e të arratisurit ka 50 (pesëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
2. **Dosje e të arratisurit, nr. 3108-D-65**, në ngarkim të A. H. Dosja e të arratisurit ka 45 (dyzet e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
3. **Dosje përpunimi nr. 28**, kategoria 2/A, në ngarkim të G. S., me 81 (tetëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

4. **Dosje personale nr. 423** dhe e **punës nr. 381**, me pseudonimin “Petriti”, në ngarkim të G. S. me 86 (tetëdhjetë e gjashtë) fletë.
5. **Fashikull personal për të dënuar nr. 132**, në ngarkim të K. R. Ç., me 12 (dymbëdhjetë) fletë.
6. **Dosje formulare nr. 2577** dhe **fashikull për të dënuar nr. 35**, në ngarkim të L. J. M. Dosja formulare 191 (njëqind e nëntëdhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit është “tepër sekret”.
7. **Dosje operative nr. 4747**, kategoria 2B, në ngarkim të I. T. B., 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
8. **Dosje e të arratisurit**, nr. 2938-D-61, në ngarkim të S. G. K., me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
9. **Dosje formulare nr. 7604**, kategoria 2/A, në ngarkim të L. Q. G., 111 (njëqind e njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
10. **Dosje formulare nr. 1270**, kategoria 2B, në ngarkim të F. Rr. H., me 21 (njëzet e një) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
11. **Dosje personale nr.12633** me pseudonimin “Trimi”, në ngarkim të L. N. V. Dosja personale ka tre volume: dosje formulare nr. 5254, dosje pune nr. 12633 dhe fashikullin për të dënuar, 141 (njëqind e dyzet e një) fletë. Dosja i përket ish-Drejtorisë së Punëve të Brendshme Tiranë. (Ana e Sigurimit)
12. **Dosje formulare nr. 12322**, kategoria 2A, në ngarkim të P. F. I. me 302 (treqind e dy) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
13. **Kartelë model 2**, me nr. regjistri 22343 për B. S. V. Niveli i klasifikimit “sekret”. 1 (një) fletë.
14. **Fletë** regjistri i agjunkturës nr. 1 Mat, model K.I, në ngarkim të H. A. R. Regjistri përmban 100 (njëqind) fletë.
15. **Fletë** regjistri i agjunkturës nr. 1, Dega IV, **nr.4310**, në ngarkim të M. H. K.

KRYETARE E KDZH-së

Gentiana Sula

VEPRIMTARI TË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT PËR PERIUdhËN JANAR-SHKURT

Arkivi i dëshmime gojore të përndjekjes komuniste

Ambasada Gjermane dhuron infrastrukturë digjitale për AIDSSH

Tiranë, 29 janar 2019 – Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zhvilloi në mjediset e tij një ceremoni me rastin e dhurimit të pajisjeve për mbledhjen e dëshmime gojore, nga Ambasada Gjermane në Tiranë, aktivitet i hapur për mediat.

Mbledhja e dëshmime gojore nga AIDSSH filloi një vit më parë, në kuadër të projektit “Përkujtojmë për të shëruar dhe parandaluar”, i mbështetur nga PNUD Shqipëri dhe Qeveria e Italisë. Në një rrugëtim mbresëlënës në mbarë vendin, projekti i nisur më 20 shkurt mbledhi dëshmi të vyera, sipas një metodologjie profesionale dhe të mirëmenduar, e cila vijon.

Znj. Gentiana Sula, kryetare e AIDSSH, foli për platformën e dëshmime gojore, zërat dhe fytyrat e viktimave e të përndjekurve politikë; rezultatet e arritura deri tani, që synojnë promovimin e vlerave demokratike të drejtësisë, së vërtetës dhe pajtimit. Sipas znj. Sula, “bashkëpunimi i nisur me Ambasadën Gjermane është i hershëm dhe ka provuar të jetë i qëndrueshëm. Pas një viti, projekti i dëshmime gojore, i lançuar më 20 shkurt 2018 në Tiranë dhe i zbatuar në të gjithë vendin, me regjistrimin e rrëfimeve të të mbijetuarve të përndjekjes e çnjerëzimit dhe bashkëbisedimet e hapura në universitete arriti të materializohet në produkte konkrete:

- një uebfaqe me emrin Edhe muret kanë veshë, platformë komunikimi përmes dëshmime të dhimbjes e mbijetesës;
- një libër me dëshmitë e të mbijetuarve të Kampit të Tepelenës, i cili do të pasohet nga vëllime të tjera;
- një marrëveshje me Zërin e Amerikës, që në bashkëpunim me Federatën Vatra ndihmojnë në mbledhjen e dëshmime gojore të bashkësisë shqiptare në Amerikë;
- dhe plotësimi i pajisjeve për realizimin e plotë të intervistave e regjistrimeve në vend, pra, në mjediset e Autoritetit dhe në mbarë Shqipërinë, nëpërmjet seteve lëvizëse, që na lejojnë të shkojmë pranë të mbijetuarve dhe t’i regjistrojmë në vendet ku jetojnë.

Formati i pyetjeve është zhvilluar me këshillën e studiuesve nga Instituti i Historisë dhe AIDSSH. Transkriptimi është bërë në zyrat e AIDSSH, ku edhe ruhen rrëfimet e regjistruara me zë e figurë. Në dukje e thjeshtë, kjo është punë voluminoze dhe e kujdesshme, dhe AIDSSH falënderon të gjithë kontribuesit, por sidomos të mbijetuarit që, ndonëse në pjesën më të madhe kanë moshë të thyer, na i besuan me durim kujtimet e tyre të dhimbshme.

Tashmë, këto dëshmi do të administrohen me kujdes dhe do t'i vihen në dispozicion çdo studiuesi, në çdo kohë, sipas rregullave të arkivave në Republikën e Shqipërisë dhe vullnetit të qytetarëve që na kanë besuar rrëfimet, përmes marrëveshjes së nënshkruar me intervistuesin. AIDSSH merr përsipër të administrojë dhe ruajë këto regjistrime, me standardin e një arkivi të vyer historik e i jep një shans më shumë mbështetjes së kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, krahas qasjes së papenguar në dokumentet e Sigurimit të Shtetit në diktaturë.”

Znj. Susanne Schutz, Ambasadore e Gjermanisë në Shqipëri u shpreh për vijimin e projektit të mbledhjes së rrëfimeve të viktimave dhe të mbijetuarve të krimeve të së kaluarës komuniste në Shqipëri. “Në emër të Qeverisë Federale Gjermane, para një viti i kam dhuruar AIDSSH-së një donacion tjetër në pajisje. Asokohe bëhej fjalë për aparatura të digjitalizimit dhe arkivimit të dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit. Edhe vizitën para një viti në vendet e ndryshme të arkivimit të këtyre dosjeve e mbaj mend shumë mirë. Me këtë rast munda të krijoj një ide konkrete rreth detyrave madhore me të cilat përballet ky Autoritet. Ndaj është kënaqësi të konstatoj se hapja e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit po ecën përpara, ndoshta ngadalë, por në mënyrë të pandërprerë.

Unë e di, ca më shumë sepse jam gjermane, që të merresh me të shkuarën tënde të errët mund të jetë e dhimbshme, por mjaft e rëndësishme për një fillim të ri shoqëror. Ndaj përshëndes përpjekjet e Shqipërisë për të mos e lënë të prehet të shkuarën e saj.

Shumëkush mund të kishte preferuar t'i vinte kapak të shkuarës e të niste prej zeros, e kështu t'ia linte harresës çështje të tilla si përgjegjësia dhe vuajtjet individuale. Por përvoja jonë tregon se vetëm kush njih të shkuarën e tij dhe përballet me të, ka edhe të ardhme.

Në këtë kontekst, veçanërisht i rëndësishëm në qasjen ndaj historisë sonë ka qenë dhe vazhdon të jetë konsolidimi i kulturës së kujtesës, edhe - e para së gjithash - përmes rrëfimeve të dëshmitarëve të kohës. Viktimat e diktaturës kanë të drejtën e kujtesës: të kujtuarit e fateve individuale të njerëzve është i rëndësishëm”.

Në mbyllje u demonstrua procesi i mbledhjes së dëshmive gojore, platforma e dëshmive Edhe Muret Kanë Veshë dhe arkivi digjital i dëshmive të regjistruara përgjatë 2018.

Edhe Muret Kanë Veshë titullohet platforma e rrëfimeve të mbledhura nga AIDSSH. Kjo platformë komunikimi synon të rrisë ndërjegjësimin mbi të kaluarën komuniste dhe të inkurajojë dialog mes universiteteve, studiuesve, komuniteteve lokale, të mbijetuarve të diktaturës dhe familjeve të tyre, medias e publikut të gjerë.

Projekti i dëshmive gojore është zgjeruar nga bashkëpunime të frytshme të Autoritetit me partnerë. Në dhjetor të 2018, u institucionalizua bashkëpunimi për mbledhjen e rrëfimeve të të përndjekurve nga diktatura komuniste në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me marrëveshjet me Zërin e Amerikës dhe Federatën Panshqiptare Vatra.

Platforma Edhe Muret Kanë Veshë dhe libri i dëshmive klikohen në faqen zyrtare të Autoritetit, e cila pasurohet në vijimësi.

Dëshmitë janë pjesë e arkivit digjital të institucionit dhe ruhen me standarde bashkëkohore, krahas arkivit të dosjeve të Sigurimit të Shtetit. Me historitë e mbledhura me kujdes dhe përgjegjësi, përmes zërave të padëgjuar, AIDSSH i jep një shans më shumë mbështetjes së kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar, krahas qasjes në dokumentet e Sigurimit të Shtetit.





“Gjirokastra lexon Musinenë”

Përkujtohet figura shumëdimensionale e Musine Kokalarit

Gjirokastrë, 12 shkurt 2019 – Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Muzeun “Musine Kokalari” dhe Wikimedians of Albanian Language UG organizoi aktivitetin “Gjirokastra lexon Musinenë”, në Gjirokastrë.

Figura shumëdimensionale e Musine Kokalarit, veprimtares politike e kulturore dhe shkrimtares me vizion u përkujtua në një simpozium të posaçëm në qytetin e saj. Paralelisht me simpoziumin, një grup të rinjsh dhe ekspertët përkatës punuan për pasurimin dhe saktësimin e materialit zyrtar për të, në punëtorinë edit-a-thon “Musine Kokalari në Wikipedian shqip”. Të ftuar në takim ishin qytetarë, të rinj e studentë, përfaqësues të institucioneve publike dhe joqeveritare, shoqatave për të drejtat e njeriut dhe të përndjekurve politikë, organizatave ndërkombëtare, artit, kulturës dhe medias.

Simpoziumi u hap nga znj. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Me kërkesë të familjes, dosja e parë që Autoriteti hapi para dy vjetësh, në nisje të punës së tij, ishte ajo e Musine Kokalarit, e dënuar, survejuar dhe përndjekur për vite me radhë. Dy vjet pas hapjes së dosjes së parë, përvjetori i Musinesë i bëri të gjithë bashkë në Gjirokastrë, për ta trajtuar në mënyrë komplekse figurën e saj e po ashtu, qëndresën dhe vlerat njerëzore të përcjella, përtej shënimeve të dosjes së përndjekjes.

Znj. Zamira Rami, Kryetare e Bashkisë Gjirokastrë mbajti fjalën e saj duke vlerësuar thellësisht figurën e Musinesë dhe duke e parë trajtimin e saj zyrtar e përfshirjen e të gjithëve aktorëve, si tërheqje shtesë për qytetin e Gjirokastrës. Studiuesja Fiona Todhri vijoi me trajtimin gjerësisht e me profesionalizëm të figurave të grave të dënuara politike gjatë regjimit komunist, mes të cilave, Musine Kokalari, gra që hodhën themelet dhe tentuan krijimin e një shoqërie të lirë e demokratike.

Një ndër kontribueset kryesore të kësaj veprimtarie, znj. Arjeta Kokalari, Drejtore e Muzeut “Musine Kokalari” foli mbi sfidat e trajtimit të trashëgimisë së saj në ditët e sotme. Në emër të familjes, znj. Linda Kokalari rrëfeu kujtimet me Musinenë, praninë në familje dhe mënyrën sesi personaliteti i Musinesë ndikoi jetën e saj dhe të të tjerëve që patën të bënin me të. Z. Nebil Çika, kryetar i Shoqatës Antikomuniste të ish-të Përndjekurve Politikë dhe i afërt me familjen Kokalari, u shpreh mbi mekanizmat e përndjekjes ndaj zonjës Kokalari dhe vlerat njerëzore me të cilat ajo u përball me strukturën shtetërore.

Studiuesja Sonila Boçi e Akademisë së Studimeve Albanologjike foli mbi qëndrimin politik të Musine Kokalarit, qasjen e saj ndaj pushtetit dhe rolin e së majtës shqiptare, përtej komunizmit,

gjatë periudhës kur lindi, synoi të zhvillohej dhe drejtimet që mori. E majta shqiptare do të trajtohet në një projekt të posaçëm të Autoritetit për rivlerësimin e ngjarjeve dhe figurave historike.

Të pranishëm në takim, qytetarë të lidhur me familjen Kokalari dhe vetë Musinenë, folën për kujtimet e lidhura me të dhe ndikimin që ajo pati në jetën e gjithsecilit, që nga dashuria për librat, qëndrueshmëria në vlerat njerëzore dhe papërkulshmëria, pavarësisht situatave të vështira jetësore. Prej tyre u sugjerua futja e veprave të saj në letërsinë shqipe, për pasurinë gjuhësore që përcjellin, ngaqë shoqëria e sotme është borxhlie ndaj Musinesë, fisnikërisë dhe thjeshtësisë së saj.

Krijimtaria e pasur letrare e Musine Kokalarit u trajtua dhe diskutua nga të rinj, të cilët lexuan pjesë të përzgjedhura nga krijimet e saj dhe e plotësuan figurën komplekse me aspektin artistik. Kësisoj, simpoziumi krijoi një kuadër të plotë të figurës së Musine Kokalarit, nga vlerësimi i vetëdijes intelektuale, integriteti dhe fryma idealiste që karakterizonte një grua të tillë, te qëndrueshmëria, dinjiteti njerëzor dhe përfaqësimi i lartë i vetvetes, ideve e prirjeve të saj, ditët e gjykimit e më pas.

Paralelisht zhvillimit të simpoziумit, në një mjedis të dytë u organizua punëtorja edit-a-thon “Musine Kokalari në Wikipedian shqip” dhe maratona e editimeve në Wikipedian në gjuhën shqipe për Musine Kokalarin, duke synuar një produkt konkret, serioz dhe të mirëmenduar për një nga personalitetet mbresëlënëse të jetës politike, kulturore, artistike e shoqërore shqiptare. Materiali përfundimtar u ndërtua duke u bazuar edhe në dosjen e digjitalizuar të Musine Kokalarit. https://sq.wikipedia.org/wiki/Musine_Kokalari

Në fund të takimit, të pranishmit zhvilluan një vizitë në shtëpinë e Musine Kokalarit dhe në burgun e Gjirokastrës.








Përkujtimi i masakrës së 26 shkurtit 1951

Në nderim të së shkuarës dhe në emër të shpresës...

Tiranë, 20-26 shkurt 2019 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në bashkëpunim me institucione publike, qytetarë, familjarë të martirëve të 26 shkurtit, të rinj dhe grupe të interesit organizoi aktivitete përkujtimore përgjatë javës 20-26 shkurt 2019. Aktivitetet ishin të hapura për median.

Më 20 shkurt, në përvjetorin e rrëzimit të shtatores së diktatorit Enver Hoxha, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës u projektua në fasadën ballore të Muzeut Historik Kombëtar instalacioni “Edhe muret kanë veshë” i artistes konceptuale Alketa Xhafa Mripa, që nderon dinjitetin njerëzor të viktimave dhe të mbijetuarve të krimeve të komunizmit. Instalacioni është një krijim shumëdimensional i kujtesës kolektive për ata që u dënuan, humbën lirinë apo jetën në burgjet dhe kampet e diktaturës komuniste. Shprehjet, dikur të ndaluara, u projektuan në formate të mëdha në fasadën ballore të Muzeut Historik Kombëtar duke ndriçuar errësirën, duke riafirmuar vlerat europianiste, që ishin dhe vizioni i rrëfimtariëve.





Përkujtimi i rrëzimit të shtatores në vitin 1991 hapi organizimet e Autoritetit përgjatë një jave, me nisma konkrete e bashkëpunim me institucionet e Presidentit të Republikës dhe Bashkinë e Tiranës, po ashtu me qytetarët e të interesuarit e drejtpërdrejtë për zbardhjen e masakrës së 26 shkurtit 1951, ku u ekzekutuan pa gjyq 22 intelektualë të pafajshëm.

Më 25 shkurt, me propozim të AIDSSH, Presidenti i Republikës nderoi me titujt për “Merita të veçanta civile” dinjitetin njerëzor të personave të përfshirë në zbardhjen, përkujtimin dhe dokumentimin e ngjarjes së 26 shkurtit, tronditëse në historinë e shtetit komunist. Përmes një narrative të mbijetesës, respektit të heshtur, solidaritetit njerëzor dhe humanizmit pa bujë, të mbështetur në fakte, Autoriteti dorëzoi pranë Presidentit të Republikës kërkesën për vlerësimin e personaliteteve të thjeshta njerëzore, njëkohësisht modele frymëzuese për shoqërinë e sotme shqiptare. Figurat e nderuara risjellin në vëmendje çështjet e vendvarrimeve të humbura dhe dinamikave njerëzore për zbulimin e së vërtetës dhe dokumentimin e saj.





Më 26 shkurt, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, Autoriteti dhe familjarët e viktimave finalizuan angazhimin e përbashkët, të nisur muaj më parë, për emërtimin “26 shkurti” të rrugës që të çon në vendekzekutimin e të martirizuarve. Një pelegrinazh i dhimbjes e shpresës për zbardhjen e të vërtetave të mbuluara nga harresa nisi në vendin e ekzekutimit dhe përfundoi në varrezat “Dëshmorët e Kombit”, ku prehen sot të pushkatuarit pa gjyq të 1951.

Ceremonia u zhvillua në fshatin Mënik të Pezës, pranë Urës së Beshirit, me pjesëmarrjen e familjarëve të shumtë, shoqatave të të drejtave të njeriut, të përndjekurve politikë dhe të rinjve të zonës. Pas përkujtimit të tragjedisë së 26 shkurtit, qytetarët u drejtuan në varrezat “Dëshmorët e Kombit”, për të nderuar intelektualët që edhe atje prehen në një varr masiv.

Autoriteti ka ndërmarrë nisma ligjore dhe hapa konkretë për kthimin e vendvarrimit të Mënikut në vend kujtese, të njohur dhe të vizitueshëm për qytetarët e të rinjtë. Sipas dëshmive, zona në fjalë është vendvarrim i zgjeruar i shumë të pushkatuarve pa gjyq për vite me radhë nga sistemi komunist. Me vlerësimin e një date si 26 shkurti dhe sjelljen në vëmendje të një vendi si Mëniku, duke hedhur dritë në të shkuarën, vlerësuar sakrificën dhe dinjitetin njerëzor të njerëzve të thjeshtë, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë kryen detyrën e vet qytetare dhe risjell në vëmendje çështjen e vendvarrimeve të humbura; impaktin social, individual e shoqëror të së drejtës themelore të njeriut për të jetuar denjësisht dhe prehur njerëzisht, përtej kohës, politikës apo ideologjive kalimtare.



Për arsyet e mësipërme, po **më 26 shkurt**, në teatrin “Metropol” të kryeqytetit, për qindra të rinj u transmetua dokumentari “Terrori 1951” i gazetarit Ferdinand Dervishi, që i njohu me masakrën e 68 vjetëve më parë. Filmi është punuar me materiale arkivore dhe dëshmi mbi ngjarjen, të atyre që e jetuan apo u ndëshkuan me pretekstin e bombës në legatën sovjetike.

Veprimtaritë për rivlerësimin e figurave, ngjarjeve historike dhe bashkëpunimi me institucionet e qytetarët ngrenë çështje të rëndësishme të të drejtave të njeriut, duke ndihmuar hedhjen dritë në të shkruarën dhe përmbushur përgjegjësinë ndaj brezave të rinj për një shoqëri demokratike.

Sigurimi dhe sporti

Ekspozohen dosje të sportistëve të përndjekur

27 shkurt 2019 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në bashkëpunim me Institutin për Demokraci Media dhe Kulturë (IDMC), në kuadër të “Ditëve të kujtesës” organizuan në mjediset e Tirana International Hotel një aktivitet përkujtimor mbi figurat e shquara të sportit shqiptar, të përndjekura gjatë viteve të komunizimit. Lejtmotivi i aktivitetit ishte sporti, i përndjekuri, i cinguari dhe i ndërpreri në mes nga dora e egër e diktaturës komuniste.

Ashtu si në çdo sferë tjetër të motivuar nga pasioni, si arti apo shkenca, edhe sporti i vuajti të gjitha format e përndjekjes së atij sistemi, i cili u mundua të zbehë pasionin dhe shpresën te këta njerëz. Regjimi komunist shqiptar e konsideroi sportin dhe edukimin fizik të popullit si një nga shtyllat ku mbështeste fort ideologjinë dhe pushtetin, duke përgatitur nga njëri dhjetëvjeçar në tjetrin breza të tërë që do të ishin të gatshëm për luftë në çdo moment kur të kishte nevojë atdheu. Një qëndrim i ngjashëm me atë të shumë diktaturave të vendeve të tjera.

Përfaqësues të AIDSSH moderuan takimin dhe trajtuan tipologji të dosjeve të sportistëve të përndjekur e dënuar. Po ashtu, sportistë të larguar nga disiplinat përkatëse për motive politike morën pjesë në takim me të rinj, gazetarë e të interesuar të shumtë.

AIDSSH ekspozoi dokumente arkivore autentike të sportistëve të survejuar, përndjekur dhe dënuar. Takimi i dha shkas interesit të shtuar të medias për fatet e sportistëve në duart e Sigurimit, e cila trajtoi me radhë figura të mirënjohura të sportit, në “darën” e armës sekrete të Partisë.









AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Adresa
Garda e Republikës, Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë
www.autoritetidosjeve.gov.al